



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM
Nr. 8, datë 04.03.2026

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME KAMËZ SH.A.

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "*Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "*Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence*" (**VKM nr.958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "*Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 04.03.2026 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike dhe Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit mbi kërkesën e shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Kamëz sh. a për licencim

Konstatoi se:

1. Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Kamëz (**UK Kamëz**) me shkresën nr.1344 prot. datë 01.07.2025 dhe plotësimet me shkresë nr.2848/2 prot. datë 24.12.2025 dhe me shkresë nr.209 prot. datë 02.02.2026 ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për rinovim licence për shkak të mbarimit të afatit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Kamëz në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

- a) Shoqëria UK Kamëz ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 126 000 banorë në Bashkinë Kamëz;
- b) Drejtues ligjor i shoqërisë në vendimin nr.102, datë 28.02.2022 “Për licencimin për herë të parë të shoqërisë ujësjellës kanalizime Kamëz sh.a.” ishte z. Gentjan Murataj, i cili në këtë aplikim është zëvendësuar nga z. Shpëtim Leskaj i diplomuar në Universitetin e Tiranës në degën Kimi Industriale në vitin 1996 me mbi 30 vite eksperiencë pune. Ka qenë administrator i kësaj shoqërie në vitet 2019-2022, duke u rikthyer përsëri në të njëjtin pozicion në vitin 2024;
- c) Drejtues teknik i shoqërisë në vendimin nr.102, datë 28.02.2022 “Për licencimin për herë të parë të shoqërisë ujësjellës kanalizime Kamëz sh.a.” ishte z. Jurgen Ocelli, i cili në këtë aplikim është zëvendësuar nga z. Bardhok Alia, i diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, dega ndërtim, me titullin ndërtim për civile dhe industriale, në vitin 1994. Z. Bardhok Alia ka qenë inxhinier pranë shoqërisë UK Kamëz sh.a në vitet 2015-2022 dhe më pas si drejtues teknik i saj, duke plotësuar dhe kushtin e VKM nr.958 për eksperiencën në sektorin UK.

4. ERRU në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Kamëz, të:

- a) Kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;
- b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar, (ligji nr. 9121) për mos lejin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;
- c) Kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” të ndryshuar;

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Kamëz është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

- 1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kamëz sh.a me NUIS L72320034A në kategoritë:
 - a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik
 - b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura

2. Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Kamëz sh.a autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:
 - a) Drejtues Ligjor – Shpëtim Leskaj
 - b) Drejtues Teknik – Bardhok Alia (për kategoritë A dhe C)
3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Kamëz sh.a është Bashkia Kamëz.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 vjeçare.
5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Kamëz sh.a detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
6. Ngarkohet Drejtoria Teknike Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime Kamëz sh.a për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Gerta Lubonja